



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJES  
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS**

Nr. 6446 Prot.

Vau Dejes me 1807  
18/07/2023

**NJOFTIM PËR DËGJESË PUBLIKE**

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 18 pika 1 dhe pika 2 , neni 54 germa (dh) dhe në rregulloren e brendshme për funksionimin e Këshillit Bashkiak Vau Dejës (VKB 23/2020) neni 154:

Këshilli Bashkiak Vau Dejës fton të gjithë banorët Fshatit Nënshatë Bashkia Vau Dejës, të bëhen pjesë me mendimet dhe sugjerimet e tyre lidhur me projekt vendimin:

**“Për hapjen e një rruge në fshatin Nënshatë, Bashkia Vau Dejës”**

(Paraqitur nga Drejtoria e planifikimit dhe zhvillimit të territorit).

Dëgjesa publike do të bëhet me datë **15.08.2023** ora **10.00** ne fshatin Nënshatë, Njësia Administrave Hajmel.

**SEKRETARI KËSHILLIT**

**Ardian CELEPIJA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**  
**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT**

Nr. 4226 prot.

Vau Dejes, më 07/07/2023

**Lenda: Dërgohet Projekt – Vendim për marrje vendimi “Për hapjen e një rruge në fshatin Nenshate, Bashkia Vau Dejes”**

**KESHILLIT BASHKIAK VAU DEJES.**

*Të nderuar anëtare të Këshillit Bashkiak, Vau Dejës,*

*Bashkëlidhur po ju dërgojme Projekt- Vendim, dhe materialin shoqërues “Për hapjen e një rruge në fshatin Nenshate, Bashkia Vau Dejes”*

**KRYETARI**  
**KRISTIAN SHKRELI**

Pergatiti :  
Dorina Lekaj ( Pergj. Sektori Planifikimi Urban dhe Sekretarise Teknike)

Verifikoi :  
Drejtorja Juridike

Stefan Jaku

Date: 10.07.2023

Nr. faqeve te projekt- vendimit 1 flete

Nr. faqeve te materialeve shoqeruese. 12 flete



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**  
**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT**

Nr. 4226 prot.

Vau Dejes, më 10/07/2023

**Projekt – Vendim**  
**Nr. 01 Date : 10 / 07 / 2023**

**“Për hapjen e një rruge në fshatin Nenshate, Bashkia Vau Dejes”**

*Mbështetur në ligjin 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” ndryshuar, neni 8, neni 9, neni 20, neni 23, neni 54 germa II. Ne ligjin nr 9270 date 29.07.2004 ndryshuar, . Në VKM 566.dt. 22.08.2012, “ për miratimin e listes përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronesi ose në përdorim të Nj. A. Hajmel Bashkise Vau Dejes, të Qarkut Shkoder”,*

Si dhe nisur nga kërkesat e vazhdueshme të banoreve të fshatit Nenshate , Nj.A. Hajmel, pas konstatimit të problematikes në terren nga IMT Bashkia Vau Dejes.

**PROPOZOJME**

- Të miratohet me vendim të Keshilli Bashkiak hapja e rruges sipas Plan Rilevimit të paraqitur nga Zyra e Kadastres Bashkia Vau Dejes.
- Keshilli Bashkiak të organizojë “Degjese Publike” në terren me banoret ku do të bëhet nderhyrja për hapjen e rrugës në interes të komunitetit.
- Një kopje Vendimi t’i dërgohet ASHK Shkoder për regjistrim.
- Të ngarkohet për zbatimin e Vendimit IMT Bashkia Vau Dejes e mbështetur nga Policia Bashkiake.

*(Bashkëlidhur kërkesa e banoreve, kopje të karta ID, Libri i ngastrave, harte perkatese, flete inventari plan rilevim, urdher pune)*

**KRYETARI**  
**KRISTIAN SHKRELI**



Konc ; Dorina Lekaj

PLAN RILEVIMI- PER POZICIONIMIN E RRUGES

PERGATITI:

Ing. Armand Velej

Liçensa T. \_\_\_\_\_ Dt. \_\_\_\_\_

Data e përgatitjes. 04.07.2023

SIPERFAQE

Sip = 165 m<sup>2</sup>

IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 2778

NR PASURISE 94/4


SHKALA 1:1000

INDEKSI I HARTES : K - 34- 76 -(53-B)

ADRESA E PASURISE

RRETHI: SHKODER FSHATI: NENSHATE

PRONARE: BASHKIA VAU DEJES



...ese  
Hajmet Bashkia Vaudejës

Dt. 14.04.2022

Yeni olisa familje në Nenshatë lagje  
Mazrek që ju objektiva që të  
Verifikoni rrugën që himë nëpër  
shtëpi tona.

Në gjykimin tonë është bërë e pa  
kalueshme pasi është ngritur  
nga persona të tjerë.

Familjet që kanë akses janë


Pjeter Kolë Pali  
Palë Kolë Pali  
Nikolin Dedë Pali

Gjyq. Pali Pali

Zef. Simoni

Stefan Pali

Prezente edhe Kryetari Fshati;



Pali



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**  
**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT DHE INVESTIMEVE PUBLIKE**

Vau Dejes, më/0/07/2023

**Relacion sqarues, “Për hapjen e një rruge në fshatin Nenshate, Bashkia Vau Dejes”**

*Të nderuar këshilltare të Këshillit Bashkiak, Bashkia Vau Dejes,*

Po ju informojme me një relacion mbi situatën, për të cilën po ju paraqesim këtë projekt vendim.

Prane Bashkise Vau Dejes, janë paraqitur banoret e fshatit Nënshate, Njesia Administrative Hajmel, ku kanë paraqitur në kërkesë me shkrim protokolluar pranë sekretarises Bashkia Vau Dejes me date 14.04.2020, gjithashtu pranë Sporteve të Zyres me 1 Ndalese me kërkesë me numer praktike 1046 date 19.04.2022 ku kerkohet si më poshte:

Të verifikohet rruga për të cilën banoret pretendojnë së nuk mund të aksesojnë për të hyre në banesat e tyre, evidentimi i problemeve të shkaktuara nga përsona të tjere që bllokojnë rrugën, dhe rivenia në funksion e rrugës.

Nisur sa me sipër, IMT Bashkia Vau Dejes, shoqëruar nga Ing. Topgraf Pergjegjesi I Sektorit të Kadastres, dhe Policia Bashkiake kanë evidentuar problematiken në terren. Ku kanë konstatuar problematiken në fjalë dhe kanë evidentuar se Bashkia Vau Dejes duhet të nderhyjë për hapjen dhe sistemimin e rruges.

Pas verifikimit nga Kadstra rezulton se behet fjalë për pasurine Nr. 94/04, Zona Kadastrale 2778, fshati Nenshate, Nj. A. Hajmel, Pasuri e cila nga libri I ngastrave figuron prona “Shtet”.

Sa me sipër, Mbështetur në ligjin 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” ndryshuar, neni 8, neni 9, neni 20, neni 23, neni 54 germa II. Në ligjin nr 9270 date 29.07.2004 ndryshuar, . Në VKM 566 dt. 22.08.2012, “për miratimin e listes përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Nj. A. Hajmel Bashkise Vau Dejes, të Qarkut Shkoder”,

Si dhe nisur nga kërkesat e vazhdueshme të banoreve të fshatit Nenshate, Nj.A. Hajmel, pas konstatimit të problematikes në terren nga IMT Bashkia Vau Dejes, po ju paraqesim projekt vendimin bashkelidhur për hapjen e rruges sipas Plan Rilevimit të paraqitur nga Zyra e Kadastres Bashkia Vau Dejes.

Konc. Relacionin; Dorina Lekaj

Verifikoi në terren, IMT Vau Dejes;  
Martin Luka

Adresa: “Rruga Qafa e Gurit” Vau Dejes, Telefon/Faks 00355 2612 0006, e-mail: [info@vaudejes.gov.al](mailto:info@vaudejes.gov.al)